

STATUT DHE AKT THEMELIMI
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE

"MONEY TALKS CHANGE"

(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", dhe, ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i nenshkruari:

•**Neim Qulli**, i biri i Edmondit i datelindjes 08.04.1997 lindur ne Fier dhe banuese ne Fier, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, pajisur me karte identifikimi me nr. ID J70408016L.

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria e quajtur **"MONEY TALKS CHANGE shpk"**

Qe ketu e me poshte referuar si "Shoqeria", e cila themelohet nga **ortaket e sipercituar**, si me poshte vijon:

QENDRA E SHOQERISE

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Konferenca e Pezes Ndertesa nr 136 AP 20 Nr.Pasurie 5/128+3+-20 perball Poliklinikes nr 9 .

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe kohore **te papercaktuar**.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

Kembim valutor. Agjent per transferim parash ne llogari te nje subjekti financiar jobankar. 3- Mirembajtje rrjeti dhe pajisjesh te teknologjise se informacionit. Veprimtari e agjentit per sherbimin e pagesave per te tretet ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke. Dhenie me qira te nje pjese te ambientit. Shoqeria do te jete gjithashtu e afte te kryeje llojet e veprimtarive tregtare qe nuk ndalohen nga legjislacioni Shqiptar. Agjensi Udhetimi, prereje biletash online, Veprimtari e agjentit komisioner

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortakë, te rrisë kapitalin sipas vendimeve te Ortakeve te Vetem dhe sipas parashikimeve te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 2500.000 leke, i ndare ne 1 kuote.

Z. Neim Qulli, zoteron kuota kapitali 100% dhe zoteron 1 (nje) kuote.

Kapitali zoterohet 100% nga ortaku i vetem i shoqerise.

Ortakët e vetem mund te vendosin te rrisin kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te ortakëve te vetem. Detyrimet e ortakëve kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre. Ortakët nuk do te kete asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.

Neni 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te zvogelohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te Asamblese se Ortakëve te Vetem te Shoqerise.

10

REGJISTRIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqëria tregtare deklarohet e knjuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e knjuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te bizneseve (QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007.

Neni 9

KALIMI I KUOTAVE

Pjeset shoqerore te ortakut te vetem perputhen me pjesen e tij ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet:

- ne kapitalin e shoqerise
- shitblerjes se kuotave
- trashegimise
- dhurimit
- çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Pjeset e tij çdo ortak i shoqërise mund t'ua ofroje te treteve, te cilet nuk jane anetare ne shoqeri. Ne rast se shoqëria do te kete ne te ardhmen me shume se nje ortak, ne kete rast ortaku i cili ka vendosur te transferoje ose te shese kuotat e tij, duhet t'i drejtoje nje kerkese me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqërise si dhe te dhenat e bleresit

E drejta e perparësisë per nenshkrimin e kapitalit eshte ne proporcion me kuotat e secilit prej ortakeve.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqërise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga çasti i kalimit te kuotave deri ne çastin e regjistrimit te kalimit.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotave sipas nenit 43 te ligjit 9723.

Neni 10

Emertimi i shoqërise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit , duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe qe ju drejtohen te tretave.



Shoqeria do te kete vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 11

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper *vetem* te drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve te Vetem te Shoqense
- Administratori i shoqense.

KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

Neni 12

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaket e *vetem* shprehen me vendime per gjithcka qe eshte ne kompetencat e tyre.

Neni 13

Marrja e vendimeve te Ortakeve te Vetem regjistrohen ne regjistrin e vendimeve te ortakeve te vetem ,mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Neni 14

THIRRJA E ASAMBLESE


Asambleja e pergjithshme thirret sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Neni 15

PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe



zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per çeshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shperndarja e shoqerise ajo mund te marre vendime te vlefshme kur vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres personalisht, ose qe votojne me shkrese po me mjete elektronike.

ADMINISTRIMI

Neni 16

Shoqeria administrohet nga nje administrator i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Vendimet e Ortakeve te vetem apo nga Asambleja e Ortakeve ne rast se shoqeria do te kete me shume ortak. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe **kohore 5 (**

pese) vjeçare, me te drejte nimerimi nepermjet vendimit te Ortakeve te Vetem te Shoqerise. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e secilit ortak,

Ortaket vendosin shkarkimin e tij. Ne asnje rast ortaket nuk i duhet te justifikojne apo provojne se cilat jane shkaqet per te cilat shkarkon administratorin. Ne çdo rast jane ortaket te cilet vleresojne nese ka shkaqe te arsyeshme per shkarkimin e administratorit.

Administratori detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme. Ai kujdeset per mbajtjen sakte dhe te rregullit te dokumenteve, dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ai pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e filimeve ja paraqet keto dokumente asamblese se pergjithshem te ortakeve per miratim.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ja jep shprehimisht Ortakeve te Vetem.

Administratori emerohet me nje afat kohor 5 (pese) vjeç ar.

Administratorit nuk i lejohet te kontraktoje me te tretet ne çfaredo lloj forme qofte, nuk i lejohet te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin per çeshtje te ndryshme ne emer te saj,

nuk i lejohej te jape paradhenie, te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te shoqerise apo te ortakeve te vetem etj., pervec rasteve kur ai ka marre nje **miratim perkates me shkrim nga ortakët.**

Administratori ka te drejte te kryejë vetem ato veprime te cilat kane te bejne me administrimin e perditshem dhe te zakonshem te shoqerise.
Administratori mund te japi prokura tek te tretet brenda kufijve qe ligji e lejon dhe ne kufijte qe i lejojne Ortaket e vetem apo Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.
Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa, detyrime per tu paguar, veprime me institucionet bankare ku perfshihen transferta bankare terheqje parash etj., do te kryhen nga administratori vetem pasi te jete dhene miratimi me shkrim nga ortakët e vetem.

Administratorja e shoqerise eshte caktuar Anxhela Sinanaj, e datelindjes 28/08/2000, lindur ne GRC dhe banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, pajisur me karte identifikimi me nr. K05828022H.

MARREDHENIET E PUNES

Neni 17

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojë rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 18

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohej te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 19

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do të emërohet dhe qendroje në detyrë sipas parashikimeve të ligjit përkatës. Ortaku cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 20

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të çështjeve të mesipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do të kalojnë ortakut të shoqërisë.

Neni 21

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Në rast se shoqëria shpërndahet për do të lloj arsye Ortaku i vetëm përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të biznesit QKB.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Çdo ndryshim bëhet në përputhje me këtë Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

Data. 08.01.2025

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Neim QULLI

Neim Qulli

